



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 9099 (31104-02860-86-2015) Rregj.Them.
Data Regjistrimi 30.04.2015

497
19.06.2015
/Z
Nr. 1170 (115) Vendimi
Datë 28.05.2015

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 28.05.2015, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

PADITËS: Engjell Turku, person fizik me NIPT K32509178M me adresë lagja "22 Tetori", Berat.

TË PADITUR: Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Berat.
Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Palë e tretë: Zyra Vendore e Avokatit të Shtetit Vlorë.

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 1740, datë 06.05.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, si dhe vendimit nr. 15273/4 Prot. datë 01.10.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.
Shfuqizimi tërësisht i akteve administrative të sipërcituara, Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 1740, datë 06.05.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, si dhe vendimit nr. 15273/4 Prot. datë 01.10.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 32, 106 të K. Pr. Civile, nent 15/c, 17/a, dhe 40 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", K. Pr.

Administrative, ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 342, datë 16.03.2015 ka vendosur :

1. *"Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.*
2. *Ndaj këtij vendimi nuk lëshohet urdhër ekzekutimi.*
3. *Ky vendim është i ekzekutueshëm prej përmbaruesit gjyqësor menjëherë.*
4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur ankim pala paditëse duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

1. *DRT Berat në shkelje të neneve 80,81, e 83 të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" nuk ka dërguar me postë tatimpaguesit, kopje të kontrollit, për të më dhënë mundësi që të kundërshtojë rezultatet e kontrollit dhe për të paraqitur provat që shtetasi Sokol Brahimi nuk është punonjësi im.*
2. *Në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje flagrante të nenit 119 pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9920/2008.*
3. *Vetëm administrata tatimore mund të kontrollojë dhe të përcaktojë detyrime për tatimpaguesin dhe asnjë organ tjetër nuk mund të hartojë akte konstatimi që mund të penalizojnë subjektin.*
4. *Metoda alternative do të zbatohet vetëm në rastin nëse do të kishte një praktikë fillestare administrative të nisur nga organi kompetent tatimor.*
5. *Në rastin objekt gjykimi në procedurën administrative të ndjekur tatimpaguesit i është mohuar e drejta për tu njohur me procedurën dhe për të marrë pjesë në procedimin administrativ. Pra palët e paditura kanë zhvilluar një procedim administrativ në kundërshtim me ligjin.*
6. *Respektimi i një procesi të rregullt ligjor do të sillte si pasojë një vendimmarrje të ndryshme nga ana e palëve të paditura.*

Sa më sipër pala paditëse kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e padisë sipas objektit. Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padi duke kërkuar:
Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 1740, datë 06.05.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, si dhe vendimit nr. 15273/4 Prot. datë 01.10.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë. Shfuqizimi tërësisht i akteve administrative të sipërcituara, Njoftim vlerësimi për detyrimet

tatimore nr. 1740, datë 06.05.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, si dhe vendimit nr. 15273/4 Prot. datë 01.10.2014 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 1, 32, 106 të K. Pr. Civile, nent 15/c, 17/a, dhe 40 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", K. Pr. Administrative, ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 342, datë 16.03.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse Engjell Turku.

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka bërë ankim paditësi Engjell Turku.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin. Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 342, datë 16.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Pala paditëse është i regjistruar si person fizik në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe ushtron aktivitetin tregtar "Bar-bilardo" dhe internet. Oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat kanë ushtruar kontroll në ambjentin ku ushtron aktivitetin tregtar paditësi Engjell Turku. Sipas procesverbalit të konstatimit të mbajtur në datën 10.04.2013 në ambjentet e lokalit të paditësit kanë konstatuar shtetasin Engjell Turku dhe Sokol Brahimaj, i cili sqaroi se ka disa ditë që punon në këtë ambient. Bazuar në këtë procesverbal konstatimi Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat me shkresën nr. 256 Prot. datë 16.04.2014 i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat të verifikojë nëse shtetasi Sokol Brahma është i siguar dhe në rast të kundërt të merret masë administrative ndaj palës paditëse.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat (DRT Berat) me shkresën nr. 959 Prot. Datë 30.04.2013 4 ka kërkuar miratimin e vlerësimit tatimor ndaj palës paditëse, duke e gjobitur me gjobë në shumën 250.000 lekë për punonjës të pasiguar sipas procesverbalit të konstatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat. Ky vlerësim është bazuar në nenin 119/a të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH".

DRT Berat me Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore nr. 1740 Prot. Datë 06.05.2014 ka gjobitur paditësin në shumën 250.000 lekë për periudhën tatimore Prill 2014 për punonjës të padeklaruar, bazuar në shkresën nr. 256 Prot. Datë 16.04.2014 të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat.

Paditësi e ka ankimuar këtë njoftim vlerësimi tatimor, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin nr. 15273/4 Prot. Datë 01.10.2014 ka vendosur "Lënien në fuqi të aktit administrativ objekt

ankimi, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 1740 Prot. Datë 06.05.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat për detyrim me gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën prej 250.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit”.

Drejtoria e Apelimit Tatimor në vendimin e mësipërm ka argumentuar se akti administrativ i DRT Berat është i bazuar në nenin 72 dhe 119 të ligjit nr. 9920/2008. Gjithashtu Drejtoria e Apelimit Tatimor ka argumentuar se bazuar në informacionin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat dhe pasi janë kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me deklarimin ose jo të shtetasit Sokol Brahimaj, i cili është konstatuar në punë në momentin e kontrollit pranë subjektit tregtar-ankues, Drejtori i DRT Berat ka miratuar riveçësimitin tatimor ndaj ankuesit Engjell Turku. Pala e paditur nuk arriti të provojë se e ka deklaruar personin e konstatuar në punë gjatë kontrollit dhe të verifikuar nga administrata tatimore në lidhje apo jo me deklarimin sipas ligjit.

Ky vendim i është dërguar paditësit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor në datën 01.10.2014 nëpërmjet shërbimit postar.

Rezulton nga vërtetimi datë ska i Posta Shqiptare Filiali Berat, se kjo e fundit nuk e ka marrë këtë vendim të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nga data 01.10.2014 deri më datë 30.10.2014. Në këto kushte paditësi i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila me shkresën nr. 15273/7 Prot. Datë 17.12.2014 “Kthim përgjigje” i ka ridërguar paditësit një kopje të njëhësuar me origjinalin të vendimit të kësaj drejtorie.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 20.01.2015 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padinë me objekt, palë të paditur dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 342, datë 16.03.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit Engjell Turku.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 342 të datës 16.03.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Gjykata çmon se në rastin konkret administrata tatimore ka vepruar bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga palët e treta dhe konkretisht Policia Gjyqësore Berat.
2. Gjatë gjykimit u vërtetua fakti se nga verifikimet e kryera nga ana e subjektit tregtar nuk është bërë deklarimi për një nga punonjësit e konstatuar aty, cka ka bërë ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore nga pala e paditur, që ka konkluduar me nxjerrjen e aktit administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore.
3. Përsa i përket pretendimeve të paditësit se në rastin konkret ka shkelje të neneve 80,81,83 të ligjit nr. 9920/2008, gjatë gjykimit u vërtetua fakti se në kontrollin e ushtruar në këtë subjekt nuk kemi të bëjmë me një kontroll operacional, por me një kontroll tematik, pra një verifikim të situatës në momentin e kontrollit në subjektin përkatës.
4. Gjykata çmon se aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse janë nxjerrë konform K. Pr. Administrative dhe ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 49/2012.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm dhe atij procedural që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 342, datë 16.03.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është i bazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Rezulton e provuar nga tërësia e akteve të administruara në gjykim se: Padiësi ushtron aktivitet tregtar shërbimesh në qytetin e Beratit. Oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat kanë ushtruar kontroll pranë palës paditëse dhe ka gjetur duke punuar në momentin e kontrollit shtetasin Sokol Brahimi, i cili ka deklaruar se ka disa ditë që punon në ambjentin ku zhvillon aktivitetin tregtar pala paditëse. Drejtorja e Policisë së Qarkut Berat në lidhje me këtë konstatim ka njoftuar palën e paditur DRT Berat. Inspektori i vlerësimit të DRT Berat pasi ka konstatuar se ky shtetas nuk është i deklaruar si i punësuar pranë palës paditëse i ka kërkuar Drejtorit të DRT Berat miratimin e vlerësimit tatimor ndaj palës paditëse për periudhën tatimore Prill 2014 për punonjës të pa deklaruar, lidhur me konstatimin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat. Në këto kushte DRT Berat me aktin administrativ-njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. 1740 Prot. datë 06.05.2014 ka vendosur të gjobisë paditësin Engjell Turku me gjobë në shumën 250.000 lekë.

Padiësi Engjell Turku ka ushtruar të drejtën e ankimit sipas ligjit dhe pasi ka shteruar rrugën administrative të ankimit i është drejtuar gjykatës duke pretenduar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, si pasojë e shkeljes flagrante të ligjit nga pala e paditur.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin objekt ankimi e ka rrëzuar padinë me argumentin se nuk jemi përpara asnjë prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

Ky vlerësim i gjykatës së shkallës së parë rezulton të jetë në përputhje të plotë me rrethanat e faktit të vërtetuara në gjykim si dhe me përcaktimet e ligjit.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse nuk janë absolutisht të pavlefshme sipas përcaktimeve të nenit 116 të K. Pr. Administrative.

Neni 116 i K.Pr. Administrative përcakton se:

“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;*
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;*
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji”.*

Rezulton se këto akte janë nxjerrë nga pala e paditur në formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe në ushtrim të kompetencave dhe autoritetit të dhënë nga ligji nr. 9920, datë

19.05.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore".

Pretendimi i palës paditëse i paraqitur në ankimin e saj përpara Gjykatës se aktet e palës së paditur janë në kundërshtim flagrant me ligjin është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova.

Rezulton se masa administrative e marrë nga pala e paditur ndaj palës paditëse është bazuar në shkeljen e ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht neni 119, pika 1 gërma "b" i këtij ligji përcakton se:

"Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendodhjen e biznesit, rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë...b) Tatimpaguesit e tjerë me gjobë prej 250.000 lekësh".

Pala paditëse nuk arriti të provonte se e ka respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar për deklarimin e punonjësve të punësuar rishtazi të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës. Gjithashtu pretendimi i saj se paditësi nuk ka qenë duke punuar në ambjentet e palës së paditur është një pretendim i pabazuar, pasi si paditësi ashtu dhe shtetasi Sokol Brahimi kanë deklaruar përpara oficerëve të policisë gjyqësore se ky shtetas ka qenë duke punuar pranë palës paditëse prej disa ditësh në momentin e kontrollit.

Gjykata Administrative e Apelit çmon të pabazuar pretendimin e ngritur nga paditësi në ankimin e tij se pala e paditur në rastin objekt gjykimi ka shkelur procedurën në lidhje me marrjen e masës administrative pasi inspektorët e saj nuk ka ushtruar kontroll pranë palës paditëse. Rezulton se pala e paditur ka proceduar në rastin konkret në marrjen e masës administrative ndaj palës paditëse, bazuar në ligjin nr. 9920/2008 dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 24/2008 dhe konkretisht pikën 72/1 të tij. Pala e paditur rezulton se e ka marrë masën administrative ndaj paditësit bazuar në *"Të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marra nga palët e treta"*. Konkretisht akti administrativ i palës së paditur është bazuar në kontollin dhe aktet e konstatimit të dërguara kësaj të fundit nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat. Gjithashtu akti administrativ-njoftim vlerësimi tatimor i DRT Berat i është njoftuar rregullisht palës paditëse.

Në lidhje me pretendimin e palës paditëse të ngritur në ankimin e saj se i është mohuar e drejta për tu dëgjuar dhe kjo përbën shkak për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative të palëve të paditura, Gjykata çmon se ky është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova. Paditësi rezulton se është ankuar pranë Drejtorisë së Apelitmi Tatimor, që e ka shqyrtuar ankimin e paditësit dhe ka vendosur rrëzimin e ankimit. Ky vendim i është njoftuar paditësit, i cili ka marrë dijeni rregullisht.

Për sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vlerësuar drejt faktin se aktet administrative objekt gjykimi nuk janë akte absolutisht të pavlefshme.

Në analizë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pretendimet e ngritura në ankim nga pala paditëse janë të pabazuara në rrethanat e faktit si dhe në përcaktimet e ligjit e si të tilla këto pretendime janë të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr.342, datë 16.03.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është një vendim i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "b" dhe 56, të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 342 datë 16.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 nga njoftimi i këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 28.05.2015

GJYQATAR
Rilinda SELIMI
d.v

GJYQATAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQATAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Leonard Stankaj
Stankaj